



UNIVERSITETI "UKSHIN HOTI" PRIZREN

UNIVERSITY "UKSHIN HOTI" PRIZREN

Fakulteti Ekonomik
Faculty of Economics

Universiteti i Prizrenit University of Prizren Univerziteti Prizren "UKSHIN HOTI"	
Pranuar më dt.	24.10.2025
Zyra e pranimit	Nr. i protokolit
308	02-652

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+381 (0) 29- 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

Për:	Senatin e Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren
Datë:	23.10.2025
Cc.	
Nga:	Komisioni vlerësues për shqyrtimin e aplikacioneve të kandidatëve për pranimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm në Fakultetin Ekonomik

RAPORTI PËR ANGAZHIMIN E BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM PËR LIGJËRATA DHE USHTRIME PËR VITIN AKADEMIK 2025/2026

Bazuar në konkursin e shpallur nga Senati i Universitetit "Ukshin Hoti" Prizren, me numër protokollit 01-641, të datës 16.10.2025, për angazhimin e personelit të jashtëm akademik në bazë të nevojave të njësive akademike, komisioni në përbërje:

1. Prof. Ass. Dr. Festim Tafolli, kryetar,
2. Prof. Ass. Dr. Kushtrim Gashi, anëtar,
3. Prof. Asoc. Dr. Florije Govori, anëtare.

për vlerësimin e kandidatëve të paraqitur për pozitat si në vijim:

RAPORTI PË VLERËSIMIN E KANDIDATËVE PËR POZITAT E ASISTENTËVE

1. Një mësimdhënës për lëndët:

Semestri Dimëror:

- Anglishtja Afariste I (AB, 4 orë L)
- Anglishtja Afariste III (AB, 2 orë L)

Kandidatët e paraqitur për këtë pikë të konkursit janë:

1. Besmir Shishko
2. Fitnete Martinaj

Tabela e përzgjedhjes së bashkëpunëtorëve për mësimdhënës:

Nr.	Kandidati/ja	Neni 6 Pika 2.1			Neni 6 Pika 4.1	Neni 6 Pika 8	Punime shkencore	Angazhimi sipas rregullores Nr. 01-377/A, dt. 24.06.2025
		Grada shkencore Dr.sc.	Dr. Sc. adekuat	Grada adekuate ne ndonjë Universitet publik	Përvojë ne UPZ	Konflikt interesi familjare		
1.	Besmir Shishko	PhDc.	Po	Jo	Po	Jo	Po	Propozohet për angazhim
2.	Fitnete Martinaj	Dr. Sc.	Po	Jo	Jo	Jo	Po	Nuk Propozohet për angazhim

Në bazë të konkursit për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm në Fakultetin e Ekonomisë të Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren, për lëndët Anglishtja Afariste I (AB, 4 orë L) dhe Anglishtja Afariste III (AB, 2 orë L), komisioni ka shqyrtuar dokumentacionin e kandidatëve dhe konstaton sa vijon:

Pas shqyrtimit të dokumenteve të paraqitura, konstatohet se kandidati **Besmir Shishko** i plotëson të gjitha kushtet e përcaktuara në konkurs, në përputhje me Rregulloren për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm nr. 01-377/A, datë 24.06.2025, konkretisht nenin 6, pikat 3.1, 3.2, 3.4, 4.1 dhe 4.2. Kandidati është në përfundim të studimeve të doktoratës në “Filozofi në Shkencat Humane” në Fakultetin e Anglistikës dhe Amerikanistikës, çka përputhet plotësisht me fushën e lëndëve të shpallura në konkurs. Prandaj, kandidati Besmir Shishko rekomandohet për angazhim në lëndët e sipërpërmendura.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, konstatohet se kandidatja **Fitnete Martinaj** i plotëson kriteret formale të konkursit, por studimet e saj të doktoratës nuk janë nga fusha adekuate për lëndët e parashikuara në konkurs. Gjithashtu, kandidatja ka pëlqim-leje nga institucioni ku është e punësuar me orar të rregullt vetëm për 6 orë akademike (gjysmë orari). Nga të dhënat rezultojnë se kandidatja është tashmë e angazhuar edhe në njësi të tjera të Universitetit “Ukshin Hoti” Prizren, gjë që kufizon mundësinë e saj për angazhim shtesë.

2. Një asistent për lëndët:

Semestri Dimëror:

- Bazat e Marketingut (AB, 4 orë U)
- Bazat e Menaxhimit Ndërkombëtar (MN, 4 orë U)

Kandidatët e paraqitur për këtë pikë të konkursit janë:

1. Diana Badalli
2. Kaltrina Krasniqi

Tabela e përzgjedhjes së bashkëpunëtorëve për asistent:

Nr.	Kandidati/ja	Neni 6 Pika 2.1			Neni 6 Pika 4.1	Neni 6 Pika 8	Punime shkencore	Angazhimi sipas rregullores Nr. 01-377/A, dt. 24.06.2025
		Grada shkencore Dr.sc.	Dr. Sc. adekuat	Grada adekuatë në ndonjë Universitet publik	Përvojë në UPZ	Konflikt interesi familjare		
1	Diana Badalli	MSc.	Jo	Jo	Po	Jo	Jo	Propozohet për angazhim
2.	Kaltrina Krasniqi	MSc.	Jo	Jo	Jo	Jo	Jo	Nuk propozohet për angazhim

Kandidatja **MSc. Diana Badalli**, e propozuar për asistente në lëndët mësimore **Bazat e Marketingut (AB, 4 orë U)** dhe **Bazat e Menaxhimit Ndërkombëtar (MN, 4 orë U)**, i plotëson plotësisht kushtet e përcaktuara në konkurs, në përputhje me Rregulloren për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm nr. 01-377/A, datë 24.06.2025, neni 6, pikat 3.1, 3.2, 3.4, 4.1 dhe 4.2.

Kandidatja **MSc. Kaltrina Krasniqi** nuk i plotëson kriteret formale për angazhim në këtë pikë të konkursit, për shkak të tejkalimit të kriterit të moshës, sipas nenit 6, pika 3.4 të Rregullores për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm, dhe për faktin se nuk ka ofruar ndonjë dëshmi për angazhim paraprak në Universitetin “Ukshin Hoti” Prizren.